



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1136/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI11/17

Parashtrues

**Aleksandar Đekić, Ljiljana Tomić, Radunka Tomić dhe
Slavoljub Tomić**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-12-0050-A0001, të 6 tetorit
2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Aleksandar Đekić, Ljiljana Tomić, Radunka Tomić dhe Slavoljub Tomić (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga avokati Halil Palaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin (AC-I-12-0050-A0001, të 6 tetorit 2016) e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), i cili u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara, me të cilat sipas pretendimeve të parashtruesve atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2017, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 31 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
8. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 24 janar 1964, me Aktvendimin nr. 35/63 të Komisionit për Arondim të Komunës së Prishtinës është urdhëruar që të bëhet arondimi i paluajtshmërisë, me të cilin nga Aleksandar Tomić ishte marrë paluajtshmëria dhe atë ngastra kadastrale nr. 1467/2 në sipërfaqe prej 0.47.33 ha dhe në vend të ngastrës së lartpërmendur i është dhënë pjesa e ngastrës kadastrale nr. 273 në sipërfaqe prej 0.54.59 ha.
10. Më 22 dhjetor 2008, parashtruesi Aleksandar Đekić paraqiti padinë pranë Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).

11. Në kërkesëpadi, parashtruesi Aleksandar Đekić kërkoj kthimin e pronës nga ngastra kadastrale nr. 1467/2, e regjistruar në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Kosova Export” (në tekstin e mëtejme: NSH “Kosova Export”), duke arsyetuar se prona e cila ka qenë objekt i shkëmbimit (pjesa e ngastrës kadastrale nr. 273) asnjëherë nuk i është dorëzuar parashtruesit Aleksandar Đekić, dhe as nuk është regjistruar në emër të tij. Parashtruesi Aleksandar Đekić ka pretenduar se ai ka vazhduar të shfrytëzojë ngastrën nr. 1467/2 pa ndonjë pengesë.
12. Më 19 janar 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si administratore e të paditurit NSH “Kosova Export” paraqiti përgjigjen në padi, në të cilën pretendoi se padia duhet të refuzohet si e papranueshme ose si e pabazuar, duke arsyetuar se Aktvendimi i Komisionit për Arondim i Komunës së Prishtinës, si një vendim ligjërish të detyrueshëm administrativ nuk mund të anulohet përmes një procedure të re kontestimore.
13. Më 20 janar 2011, Kolegji i Specializuar (Aktvendimi SCC-08-0304) refuzoi padinë si të pabazuar, duke arsyetuar se *“vendimi i vitit 1964 nuk ishte kundërshtuar sipas Ligjit për Procedurën Administrative të vitit 1986 dhe se pronësia e pasurisë së shkëmbyer do të ishte çështje e përmbarimit të vendimit e jo e vlefshmërisë së tij. Padia pronësore, në bazë të parashkrimit fitues do të ishte e pabazuar në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (nr. 6/1980).”*
14. Më 12 prill 2011, parashtruesi Aleksandar Đekić paraqiti ankesë pranë Kolegjit të Apelit kundër Aktvendimit (SCC-08-0304) të Kolegjit të Specializuar.
15. Më 2 dhjetor 2011, Kolegji i Apelit (Aktvendimin ASC-11-0045) pranoi ankesën si të bazuar, anuloi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar dhe e ktheu lëndën në rigjykim. Kolegji i Apelit konsideroi se *“Kolegji i Specializuar gabimisht kishte zbatuar ligjin që nuk ka qenë në fuqi në kohën e vendimit të kundërshtuar (Ligji për Procedurën Administrative, 1986) [...]”*.
16. Më 30 mars 2012, Kolegji i Specializuar urdhëroi parashtruesin Aleksandar Đekić që të sigurojë vendimin e trashëgimisë me të cilin dëshmohet se ai është trashëgimtar i Aleksandar Tomić (i cili ishte babai i tij) në emrin e të cilit është Aktvendimi nr. 35/63 të Komisionit për Arondim të Komunës së Prishtinës.
17. Më 17 prill 2012, parashtruesi Aleksandar Đekić dorëzoi në Kolegjin e Specializuar vendimin e trashëgimisë të 21 janarit 1960 (të gjyshes së tij, Jorgacije Tomić (Đekić)). Në bazë të këtij vendimi për trashëgiminë trashëgimtarë të Jorgacije Tomić (Đekić) janë: Aleksandar Tomić, Slavoljub Tomić, Radunka Tomić dhe Ljiljana Tomić.
18. Njëkohësisht, parashtruesi Aleksandar Đekić dorëzoi në Kolegjin e Specializuar padinë e plotësuar në Kolegjin e Apelit në të cilën kërkoj që parashtruesit Ljiljana Tomić, Radunka Tomić dhe Slavoljub Tomić t'i bashkohen procedurës si paditës.

19. Parashtruesit nuk e dorëzuan vendimin e trashëgimisë me të cilin dëshmojnë se ata janë trashëgimtarët e Aleksandar Tomić (në emrin e të cilit është Aktvendimi nr. 35/63 i Komisionit për Arondim i Komunës së Prishtinës).
20. Më 11 maj 2012, godine, Kolegji i Specializuar, me Aktgjykimin SCC-08-0304, refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar.
21. Kolegji i Specializuar theksoi se vetëm parashtruesi i kërkesës Aleksandar Đekić konsiderohet si paditës në kontest, e jo parashtruesit Slavoljub Tomić, Radunka Tomić dhe Ljiljana Tomić. Kolegji i Specializuar nuk i pranoi paditësit e rinj *“sepse e paditura (NSH-AKP) kundërshtoi këtë dhe se do të kërkonte shtyrjen e vendimit”*.
22. Më 10 korrik 2012, parashtruesi Aleksandar Đekić paraqiti ankesë pranë Kolegjit të Apelit, në të cilën pretendoi si në vijim: *“vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike për shkak të faktit se trashëgimtarë të pronës kontestuese janë edhe vëllai dhe dy motrat e paditësit, shkelje e nenit 182 të procedurës kontestimore dhe arsytim kontradiktor me dëshmitë dhe se dispozita nga aktvendimi i 24 janarit 1964 nuk është zbatuar në përputhje me rrethanat në librin kadastral”*.
23. Më 10 qershor 2016, Kolegji i Apelit urdhëroi parashtruesin Aleksandar Đekić të dorëzojë një kopje të certifikatës së tij të lindjes dhe vendimin mbi trashëgiminë me të cilin vërtetohet e drejta e tij e trashëgimisë pas vdekjes së babait të tij Aleksandar Tomić. Kolegji i Apelit e paralajmëroi parashtruesin Aleksandar Đekić se mosdorëzimi i vendimit do të rezultojë me hedhjen poshtë të padisë.
24. Më 6 tetor 2016, Kolegji i Apelit me Aktvendimin (AC-II-12-0050-A0001), refuzoi ankesën si të pabazuar, ndryshoi (Aktgjykimin SCC-08-0304) të Kolegjit të Specializuar, duke konkluduar se padia është dashur të hidhet poshtë si e papranueshme, për shkak se paditësi ka dështuar të sigurojë prova relevante lidhur me interesin e tij ligjor, duke arsyetuar se:

“... dëshmitë lidhur me të drejtat e trashëgimisë janë kusht për pranueshmërinë e padisë në rastet kur paditësit kërkojnë të drejtat e fituara me trashëgimi. Lidhur me kushtet e pranueshmërisë, Gjykata duhet t'i shqyrtojë ex officio. Në përputhje me këtë detyrë zyrtare, gjykata dërgoi një urdhër tek ankuesi i cili është gjithashtu edhe paditës, me datë 10 qershor 2016, duke kërkuar vendimin e trashëgimisë, por paditësi dështoi të paraqesë të njëjtin. Për këtë arsye dhe pavarësisht nga arsyet e ankesës, vendimi i shkallës së parë duhet të ndryshohet dhe padia të hedhet poshtë si e papranueshme”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës së pari pretendojnë se Aktvendimi nr. 35/63 i Komisionit për Arondim të Komunës së Prishtinës (i vitit 1963) nuk është zbatuar në tërësi, duke arsyetuar se *“... Komuna e Prishtinës [...] Aktvendimin e cekur më lart edhe pse ka pas obligim ligjor që ta zbatojë në tërësi nuk e ka*

bërë këtë veprim por e ka zbatuar pjesërisht duke i dëmtuar palët paditëse - paraqitësit e kësaj kërkesë”.

26. Më tej, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktvendimi i kontestuar ka qenë i kundërligjshëm në momentin e nxjerrjes së tij sepse nuk i ka përfshirë katër trashëgimtarët, por vetëm Aleksandar Tomić. Gjithashtu, parashtruesit theksojnë se ngastrën kontestuese “...e kanë pas gjithnjë në posedim dhe shfrytëzim e pa penguar nga askush dhe nga ky fakt bashkëpronarët nuk kanë qenë në dijeni me ndërrimet formale që janë bërë, me qenë se i padituri KBI nuk e ka pas në posedim këtë paluajtshmëri”.
27. Në bazë të asaj që u tha më sipër, parashtruesit arsyetojnë se “në këtë rast është shkel Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pra është shkel e drejta e garantuar e pronës, prona private është e shenjtë dhe e pa cenueshme dhe askush, qoftë edhe organi shtetëror nuk ka të drejtë ta cenojë, siç është bërë në rastin konkret përveç kur është e paraparë me ligj. Në rastin konkret është bërë shkelje e nenit 31 të Kushtetutës, e drejtë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.
28. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

“.. Të shpallet i pavlefshëm Aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-12-0050-A0001 të dt. 06.10.2016 dhe të urdhërohet shqyrtimi meritor i çështjes”.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
31. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parashikon:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

32. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) d) dhe (2) a) të Rregullores së punës, i cili parashikon:
- (1) *Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
 [...]
 d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
- (2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:*
 [...]
 (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie”.
33. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese dhe se i kanë shteruar mjetet efektive juridike, dhe rrjedhimisht i kanë përmbushur kushtet procedurale të parashikuara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të vërtetuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.
34. Së pari, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga katër parashtrues të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse Aktvendimi i Kolegjit të Apelit AC-II-12-0050-A0001 zbatohet vetëm për parashtruesin e kërkesës Aleksandar Đekić.
35. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës e kanë ndërtuar rastin e tyre mbi baza ligjore, respektivisht mbi vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike lidhur me të drejtën e trashëgimisë dhe vlefshmërinë e Aktvendimit të kontestuar nr. 35/63 të Komisionit për Arondim të Komunës së Prishtinës, si dhe mbi vlerësimin e gabuar të provave nga gjykatat e rregullta.
36. Së pari, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës janë urdhëruar dy herë të paraqesin vendimin e trashëgimisë me të cilin dëshmojnë se janë trashëgimtarët e Aleksandar Tomić në emrin e të cilit është Aktvendimi nr. 35/63 i Komisionit për Arondim të Komunës së Prishtinës.
37. Më tej, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit arsyetuan për çfarë arsye parashtruesit e tjerë nuk mund t'i bashkëngjiten kërkesëpadsisë së parashtruesit Aleksandar Đekić, si dhe që parashtruesi Aleksandar Đekić është paralajmëruar nga Kolegji i Apelit “*se mos ofrimi i vendimit të trashëgimisë, do të rezultojë me hedhjen poshtë të padisë*”.
38. Në fund, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-12-0050-A0001 i ka arsyetuar në detaje arsyet për hedhjen poshtë të padisë si të papranueshme, duke theksuar “*...dëshmitë lidhur me të drejtat e trashëgimisë janë kusht për pranueshmërinë e padisë, në rastet kur paditësit kërkojnë të drejtat e fituara me trashëgimi...*”.
39. Për shkak të asaj që u tha më sipër, Gjykata nuk do t'i shqyrtojë më tej pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me gjendjen faktike, sepse nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vërtetojë nëse lloji i caktuar i provave është

i lejuar, cilat prova duhet të merren dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe të cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së dëshmive (shih, rastin *Dukmedjian kundër Francës*, parashtrës nr. 60495/00, paragrafi 71, GJEDNJ, Aktgjykimi i 31 janarit 2006).

40. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
41. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kishin mundësinë për t'i prezantuar para gjykatave të rregullta arsyet materiale dhe ligjore për zgjidhjen e kontestit; argumentet e tyre ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit; procedurat, e shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe vendimet e marra ishin të arsyetuara në detaje.
42. Gjykata, më tej, konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, ky fakt nuk mundet vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis* rastin *Mezotur - Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
43. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur pretendimin për shkeljen e të drejtave të tyre dhe nuk kanë shpjeguar se si dhe pse Aktvendimi i Kolegjit të Apelit mund t'i ketë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese; ata vetëm kanë theksuar se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ata nuk kanë ofruar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, *Trofimchuk kundër Ukrainës*, GJEDNJ, paragrafët 50-55, Aktgjykimi nr. 4241/03, i 28 tetorit 2010).
44. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
45. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të precizuara më tej me Ligj dhe të parashikuara me Rregullore të punës.
46. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve është e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) (a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shtator 2017, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Bekim Sejdiu

Gjyqtari raportues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi